



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 1401 prot.

Shkodër, më 13. 04 .2022

V E N D I M

Nr. 32 , datë 13 . 04 .2022

"Për miratimin e Manualit të cilësisë në USH"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, germa "d"; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, germa "r", Senati akademik, në mbledhjen e tij të datës 13.04.2022

Vendosi:

1. Miratimin e Manualit të cilësisë në USH (materiali bashkalidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Prof. dr. Suzana GOLEMI





UNIVERSITETI I SHKODRËS

“Luigj Gurakuqi”

MANUAL I CILËSISË NË USH

Shkodër, Prill, 2022

Shkurtime

- Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në USH = KGSC në USH
- Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, pjesë e Drejtorisë së = NJSBC Kurrikulave, Standardeve dhe Kërkimit Shkencor
- Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë = KGSC në njësitë kryesore në njësitë kryesore
- Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit = GV

PJESA I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Baza ligjore

Manuali mbështetet tek:

- Ligj Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Vendim nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”.
- Vendimi Nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
- Udhëzimi Nr.31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”.
- Udhëzimi nr.15, datë 04.04.2008 “Për Organizimin e studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë”.
- Statuti i USH-së, miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr.366, datë 05.07.2018 “Për miratimin e Statutit të Universitetit” Luigj Gurakuqi”, Shkodër”.
- Vendim i Bordit të Akreditimit Nr.14, datë 01.02.2019, Manual “Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit kombëtar të studentëve”.
- ASCAL, Manual-Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, Tiranë 2017.
- Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL).
- Vendim Nr.824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”.

Neni 2

Objekti

Objekti i këtij Manuali është të përcaktojë organizimin dhe funksionimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë si dhe procedurat e metodat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional.

Neni 3

Qëllimi dhe objektivat

Manuali ka qëllim të sigurojë dhe të monitorojë sigurimin e cilësisë në USH dhe të programeve të studimit.

Objektivat kryesorë të këtij manuali janë:

1. Hartimi i politikave dhe procedurave të vlerësimit të cilësisë.
2. Miratimi dhe propozimi i standardeve dhe treguesve të cilësisë në kuadër të “vlerësimit të jashtëm”;
3. Realizimi i analizës së ndërlidhjes midis procesit mësimor dhe punës kërkimore-shkencore dhe asaj SWOT (mundësitë dhe pengesat e institucionit);
4. Krahasimi i arritjeve të IAL-së me standardet më të mira të universiteteve më prestigjioze evropiane.
5. Informimi, ndërgjegjësimi dhe nxitja e të gjithë aktorëve për zbatimin e rekomandimeve.

Neni 4

Subjektet

Në kuptimin e këtij Manuali subjekte janë të gjitha grupet e interesit të përfshirë në vlerësimin e sigurimit të cilësisë: Rektorati, njësitë kryesore, njësitë bazë, studentët, stafi akademik dhe administrativ dhe subjekte të tjera që kontribuojnë në zhvillimin e veprimtarisë së USH-së.

Neni 5

Fusha e veprimit

Manuali rregullon sigurimin e cilësisë për vlerësimin e brendshëm intitucional dhe vlerësimin e programeve të studimit, në fushat e mëposhtme:

1. Vlerësimi i brendshëm institucional, përfshirë menaxhimin e universitetit dhe njërive kryesore e bazë të tij, burimet njerëzore (akademike dhe administrative), infrastrukurore dhe financiare (përfshirë edhe mbështetjen financiare).

2. Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit përmes rishikimit të misionit dhe objektivave të programeve ekzistuese si dhe brendisë së tyre për një përshtatje më të mirë me objektivat e USH-së dhe tregun e punës, hartimit dhe miratimit të programeve të reja të studimit.
3. Vlerësimi i procesit mësimor, kërkimit shkencor (përmes vlerësimit të rezultateve të kërkimit dhe përfshirjes së studentëve në kërkim) dhe veprimtarive të tjera (artistike e sportive), vlerësimi i performancës së stafit akademik (përmes vlerësimit të përgjegjësve të njësisë bazë dhe studentëve) dhe administratës.
4. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik.
5. Literatura, tekstet mësimore, biblioteka.

Neni 6

Parimet e vlerësimit të cilësisë

1. Vlerësimi i cilësisë kryhet duke u mbështetur në standardet europiane e kombëtare të cilësisë, në përputhje me misionin, qëllimin dhe objektivat e përcaktuara në strategjinë e USH-së.
2. Vlerësimi i cilësisë zbatohet në respektim të parimit të autonomisë institucionale.
3. Procesi i vlerësimit të cilësisë duhet të jetë transparent dhe t'i shërbejë krijimit të kulturës së vlerësimit, duke ndërgjegjësuar dhe përfshirë të gjithë aktorët në realizimin e detyrave dhe mbajtjen e përgjegjësive.
4. Procesi i vlerësimit të cilësisë realizohet periodikisht.
5. Vlerësimi i cilësisë realizohet bazuar në standarde e tregues të përcaktuar.
6. Vlerësimi i cilësisë kryhet për të gjithë veprimtarinë në USH (mësimore, kërkimore dhe administrative).
7. Studentët janë pjesëmarrës në procesin e vlerësimit përmes plotësimit të pyetësorëve (në ruajtje të anonimitetit të tyre) dhe forma të tjera të vlerësimit, si: intervista, fokus grupe dhe pjesëmarrjes në ekupe vlerësimi.
8. Procesi i vlerësimit të cilësisë realizohet bazuar në të dhëna që vijnë nga burime të shumëllojshme; të dhënat duhet të jenë të besueshme dhe të vlefshme.
9. Procesi i vlerësimit të cilësisë duhet të vendosë një balancë mes metodave sasimore dhe cilësore si dhe mes vlerësimit të brendshëm, vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm.

10. Rezultatet e vlerësimit duhet të jenë të dobishme për hartimin/rishikimin e politikave dhe planit strategjik të USH-së, për stafin akademik, administrativ e studentët; për subjektet publike e private me të cilët bashkëpunon USH dhe të gjithë subjektet e tjera të interesuara.

PJESA II

Strukturat e sigurimit të cilësisë në USH

Neni 7

Në USH në rang universiteti dhe në njësitë kryesore krijohen strukturat për garantimin e standardeve të cilësisë dhe të programeve të studimit si në vijim:

1. Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në USH.
2. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave, Standardeve dhe Kërkimit Shkencor.
3. Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në rang njësie kryesore.
4. Komisioni në rang njësie bazë (Grupet e Vlerësimit të Brendshëm) (GVB).

Neni 8

Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në USH

1. KGSC në USH është një strukturë kolegjiale me funksione akademike, e ngritur në nivel institucional. Komisioni përbëhet nga të paktën një përfaqësues për çdo njësi kryesore, përfaqësues nga Drejtoria e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve dhe të paktën një student. Përfaqësuesit nga njësitë kryesore dhe studentit/studentët vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik i USH-së për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Komisioni harton Rregulloren e funksionimit të tij, e cila miratohet nga Senati i USH-së. Në çdo fillim viti akademik Komisioni harton planin e veprimit për vitin akademik në vijim.

2. Komisioni ushtron detyrat e mëposhtme:

- a. sigurimin e cilësisë në USH, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë;
- b. monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së USH-së, duke u bazuar mbi udhëzuesit e ASCAL-it dhe Kodin e Cilësisë;

c. vlerësimin paraprakisht të cilësisë së programeve të studimit që ofrojnë njësitë bazë dhe monitorimin e cilësisë së tyre;

d. siguron ngritjen dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në USH;

e. harton dhe miraton procedurat, kriteret dhe formatet e vlerësimit të cilësisë akademike në USH.

Neni 9

Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)

Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë ka këto detyra:

1. harton politika dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat miratohen në Senatin Akademik;
2. vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore;
3. në fund të semestrit, para sezonit të provimeve, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi;
4. realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë;
5. harton dhe i propozon Senatit standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë;
6. prezanton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së USH-së në Senatin Akademik, i cili miraton raportin vjetor përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në USH.

Neni 10

Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në

njësitë kryesore

1. Anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore përbëhen nga të paktën një përfaqësues për çdo njësi bazë. Ata vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore të USH-së midis anëtarëve të saj, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Në përbërje të këtyre komisioneve studentët përfaqësohen me të paktën një anëtar.
3. Në përbërje të këtyre komisioneve ekspertët e jashtëm përfaqësohen me të paktën një anëtar.
4. KGSC në njësitë kryesore ushtrojnë detyrat e mëposhtme:
 - a. sigurimin e cilësisë në njësitë kryesore, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë;
 - b. monitorojnë dhe vlerësojnë cilësinë e njësive kryesore, duke u bazuar mbi udhëzuesit e ASCAL-it dhe Kodin e Cilësisë;
 - c. vlerësojnë paraprakisht cilësinë e programeve të studimit që ofrojnë njësitë bazë dhe monitorojnë cilësinë e tyre;
 - d. sigurojnë ngritjen dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në njësitë kryesore;
 - e. hartojnë dhe miratojnë procedurat, kriteret dhe formatet e vlerësimit të cilësisë akademike në njësinë kryesore.

PJESA III

Sigurimi i cilësisë

Neni 11

Sigurimi i cilësisë dhe metodologjia e monitorimit

1. KGSC në USH siguron cilësinë në USH, përmes ngritjes dhe funksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në USH dhe njësitë kryesore. Komisioni harton një procedurë ku përfshihen mekanizmat e instrumentet për realizimin e analizave dhe hartimin e rekomandimeve për përmirësimin e cilësisë që u drejtohet për diskutim strukturave në USH (Universitet, Fakultet, Departament) dhe organeve drejtuese.
2. KGSC në USH realizon monitorimin bazuar në analizën e raportit vjetor të institucionit dhe informacionit të përcjellë në rrugë shkresore nga Rektorati lidhur me:
 - organizimin dhe menaxhimin e institucionit, strategjinë e zhvillimit dhe monitorimin e zbatimit të saj, politikën e kontrollit buxhetor dhe financiar, mjediset dhe infrastrukturën e përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore, systemin e informimit;
 - kurrikulën e çdo programi studimi, politikën që ndjek USH për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar;

- nxitjen e debatit konstruktiv dhe politikën e zhvillimit social;
- politikën e punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore;
- politikën për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të aftësive të personelit;
- shërbimet universitare për studentët, informimin e studentëve dhe cilësinë e komunikimit ndërmjet tyre dhe personelit akademik.

3. KGSC në USH siguron ngritjen e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në njësitë kyesore, përmes grumbullimit çdo vit të informacionit nga njësitë kryesore lidhur me: ekzistencën e GVB-ve (grupeve të vlerësimit të brendshëm) për çdo program studimi që ofrojnë dhe KGSC në njësitë kryesore.

4. KGSC në USH siguron ngritjen e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në njësitë kyesore, përmes grumbullimit çdo vit të informacionit nga Drejtoria e Kurrikulës, Kërkimit Shkencor dhe standardeve lidhur me hartimin e RVB-ve për çdo program studimi dhe shqyrtimit të tyre.

5. Procesi i sigurimit të cilësisë mbështetet në bashkëpunimin ndërmjet të gjitha strukturave përgjegjëse, brenda kompetencave të përcaktuara nga Statuti.

Neni 12

Procedurat, kriteret dhe formatet e vlerësimit të cilësisë në USH

1. KGSC në USH harton Manualin e Cilësisë në USH, i cili miratohet nga Senati, me propozim të KGSC-së në USH. Manuali diskutohet paraprakisht nga stafi akademik dhe joakademik, sugjerimet e të cilëve shqyrtohen nga KGSC në USH. Sugjerimet që nuk janë përfshirë në draftin përfundimtar që dërgohet për miratim, janë pjesë e relacionit që shoqëron draftin.
2. NJSBC, mbështetur nga KGSC në USH, harton, miraton dhe realizon procesin e plotësimit të pyetësorëve me studentët, lidhur me programet e studimit dhe me lëndët.
3. NJSBC, mbështetur nga KGSC në USH, harton raportin vjetor për sigurimin e cilësisë dhe e dërgon për miratim në Senatin akademik të analizës së të dhënave të përfuara nga pyetësi lidhur me cilësinë e programit të studimit i zhvilluar me studentët e diplomuar.
4. USH harton dhe miraton Manualin për vlerësimin e performancës së stafit akademik.

Neni 13

Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit

1. Vlerësimi paraprak i cilësisë së programeve të studimit realizohet nga KGSC në USH përmes:

- Shqyrtimit të programeve të ofruara (organizimit dhe administrimit të tyre).

- Shqyrtimit të aspekteve që lidhen me procesin mësimor, politikës së zgjedhjeve të teksteve dhe përdorimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore; infrastrukturës mësimore. Monitorimi mbështetet në vlerësimet periodike të kësaj veprimtarie dhe rezultatet e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi të kryera nga NJSBC.

- Shqyrtimit të burimeve njerëzore, financiare dhe të infrastrukturës.

- Ndërkombëtarizimit të programeve.

- Shqyrtimit të procedurave lidhur me shërbimet, informimin dhe komunikimin me studentët.

- Shqyrtimit të rezultateve të pyetësorit të realizuar me studentët e sapodiplomuar lidhur me cilësinë e programeve të studimit.

2. Monitorimi i programeve bëhet periodikisht në lidhje me efektivitetin e tyre. NJSBC realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.

Neni 14

Sigurimi i cilësisë së procesit mësimor

Sigurimi i cilësisë së procesit mësimor realizohet përmes:

1. Organizimit të procesit mësimor në mënyrë që studenti të aplikojë konceptet themelore, zhvillojë aftësitë komunikuese, kërkuese dhe bashkëpunuese gjatë punës në grup, aftësitë e të menduarit krijues.

2. Sigurimit të kapaciteteve të nevojshme për lektorë dhe sigurimit të cilësisë së stafit akademik dhe joakademik.

3. Sigurimit të kushteve të përshtatshme për punën kërkimore- shkencore, përmirësimin të vazhdueshëm të metodologjisë së mësimdhënies, sigurimit të literaturës bazë dhe asaj të këshilluar në bibliotekë (përfshirë dhe atë digjitale).

4. Sigurimit të përdorimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore dhe infrastrukturës mësimore.

5. Realizimit të pyetësorit me studentët lidhur me performancën e stafit akademik, i cili zhvillohet në fund të çdo semestri dhe adreson karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese

e profesionale të pedagogut, etikën, metodologjinë e mësimdhënies, korrektesën dhe transparencën në vlerësimin e studentit.

Neni 15

Sigurimi i cilësisë së procesit kërkimor-shkencor

1. Sigurimi i cilësisë në punën kërkimore shkencore realizohet përmes realizimit të saj dhe projekteve shkencore në përputhje me planin strategjik dhe misionin e USH-së, nevojave dhe pritshmërisë së shoqërisë, praktikave ndërkombëtare dhe burimeve të brendshme dhe të jashtme që USH ka në dispozicion për kërkimin shkencor.

2. Treguesit e vlerësimit të punës kërkimore- shkencore janë:

- Numri i publikimeve sipas legjislacionit në fuqi;
- Numri i projekteve të aplikuara.
- Numri i projekteve të realizuara;
- Pjesëmarrja në konferenca, seminare, borde editoriale.

Neni 16

Mbledhja e të dhënave

1. Të dhënat mblidhen përmes burimeve të shumëllojshme, si: studentë, stafi akademik dhe joakademik, drejtuesit dhe ekipet e vlerësimit të brendshëm e të jashtëm.

2. Monitorimi kryhet përmes instrumenteve të ndryshëm, si: raporte vlerësimi e vetëvlerësimi, pyetësorë, intervista, fokus grupe, skeda vrojtimi etj. Monitorimi kryhet përmes analizës së të dhënave sasisore e cilësore.

Neni 17

Raportimi dhe publikimi i të dhënave

Procesi i sigurimit të cilësisë duhet të jetë transparent dhe i dobishëm për subjektet e interesuara. Të dhënat e vlerësimit bëhen të njohura për stafin dhe studentët e USH-së duke u publikuar në faqen zyrtare të USH-së.

Neni 18

Akreditimi

1. USH i nënshtrohet dy formave të akreditimit të parashikuar në ligj:

-Akreditimit institucional.

- Akreditimit të programeve të studimit.

2. NJSBC harton dhe ndjek zbatimin e planit të akreditimit. Ajo organizon, ndjek dhe koordinon proceset e akreditimit në bashkëpunim me strukturat e tjera në USH.

3. NJSBC përditëson të dhënat në sistemin e ASCAL.

Neni 19

Miratimi, interpretimi dhe rishikimi

1. Manuali për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit miratohet nga Senati Akademik.

2. Interpretimi i Manualit bëhet nga Senati Akademik.

3. Rishikimi i Manualit bëhet me propozim të NJSBC-së, bazuar në sugjerimet e ardhura nga strukturat drejtuese akademike në USH dhe miratohet nga Senati Akademik .

Neni 20

Hyrja në fuqi

1. Manuali i cilësisë në USH, i miratuar sipas procedurave ligjore, hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik.

Miratuar me

- *Vendim Nr. 32 Datë 13.04.2022, të Senatit Akademik të USH-së.*



Grupi i punës:

- a. Alva Dani
- b. Bresena Kopliku
- c. Brikenë Dionizi
- d. Dorjan Ulaj
- e. Emiljano Pjetri
- f. Fatbardha Osmanaga
- g. Irma Baraku
- h. Nikoleta Frroku
- i. Gresi Kodraliu

